



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

BORDI

VENDIM

Nr. 28, datë 30.03.2017

PËR

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “EUROTRADE SECURITIES” SH.A., SI SHOQËRI
BROKERIMI PËR USHTRIM VEPRIMTARIE TREGTIMI NË TITUJ
DHE LICENCIMIN E Z. ARBËR BEGAJ SI BROKER NË EMËR DHE PËR LLOGARI
TË SHOQËRISË “EUROTRADE SECURITIES” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 49, 61, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, si dhe të Rregullores nr. 165, datë 23.12.2008 “Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarëve të investimeve”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë “Eurotrade Securities” sh.a., si shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Licencimin e Z. Arbër Begaj, si broker për tregtimin e titujve në emër dhe për llogari të shoqërisë “Eurotrade Securities” sh.a.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI